



ANNA SCIACCA
MBIKËQYRËSE

973-340-5000, SHTOJCA 2334
ASCIACCA@GBOE.ORG

14 mars 2020

Të nderuar prindër dhe anëtarë të komunitetit të shkollave të Garfield-it:

Zyrtari ekzekutiv i kontesë Xhejms Tedesco (James Tedesco) ka urdhëruar mbylljen e të gjitha shkollave publike të kontesë, duke filluar nga e hëna, më datë 16 mars 2020, si përgjigje ndaj numrit në rritje të rasteve të infektuara me virusin COVID-19 në kontenë e Bergen-it. Të gjithë e kuptojmë se kjo është një situatë e panjohur dhe se është e rëndësishme që të qëndrojmë të fortë, të ndjekim udhëzimet për të ruajtur shëndetin dhe të ndihmojmë njeri-tjetrin ndërkohë që punojmë për të dalë nga kjo krizë.

Periodha e mësimnxënies nga largësia do të fillojnë të hënën, më datë 16 mars 2020. Rrethi shkollor ka pajisjet për të ofruar përvojë të çmuar mësimnxënieje, si nëpërmjet nxënies virtuale, ashtu edhe nëpërmjet punës me materialet e shtypura të përgatitura. Për klasat K deri në 12, këtu përfshihen detyrat për matematikën, anglishten, shkencën, studimet sociale, gjuhët e botës, artin, muzikën, shëndetësinë, teknologjinë dhe edukatën fizike.

Mësimet për nxënien në largësi mund t'i gjeni në faqen e internetit të rrethit shkollor: www.gboe.org në tabelën "REMOTE LEARNING"(nxënia në largësi), në ekstremin e djathtë të tabelës lejla/mavi. Linqet për këto mësim gjenden edhe në faqet e internetit të shkollave dhe të mësuesve për klasat PreK-12. Të gjithë anëtarët e stafit do të punojnë nga shtëpia dhe do të jenë të disponueshëm përmes komunikimit me email.

PRE-K

ECLC DHE GPPA 1 (3 Saints) : Paketat mësimore do të mund t'i merrni në shkollë të hënën, më datë 16 mars, nga ora 10:00 e paradites deri në orën 12:00 të drekës.

GPPA 3 (Head Start): paketat tashmë janë shpërndarë. Nëse nuk e keni paketën, ju lutem, kontaktoni me shkollën që të bëhen aranzhimet e duhura.

KLASAT K-5

Të hënën, më datë 16 mars, të gjithë nxënësit duhet të fillojnë të kenë qasje në detyrat për nxënie në largësi, duke përzgjedhur nivelin përkatës të klasës në tabelën "Remote learning" (nxënia në largësi). Nxënësit duhet të kryejnë detyrat e përcaktuara si "Dita 1" (day 1) të hënën, më datë 16 mars, dhe më pas duhet të vazhdojnë me detyrat e përcaktuara për secilën ditë.

Paketat mësimore për nxënësit do të mund t'i merrni në shkollën e fëmijës suaj ditën e MARTË, më 17 MARS midis orës 10:00 të paradites dhe 12:00 të drekës. *Ju lutem, mbani parasysh se për shkak të vëllimit shumë të madh të kopjeve të nevojshme, rrethi shkollor nuk do t'i ketë gati paketat të hënën. Nxënësit do të jenë përgjegjës për kryerjen e të gjitha detyrave në paketë, duke filluar nga "Dita 1".*

Mësuesit, këshilluesit, punonjësit socialë, bihevizistët, do të jenë të disponueshëm për t'iu përgjigjur çdo pyetjeje, për të ofruar mbështetje akademike dhe këshillim socio-emocional.

Detyrat e kryera për secilën ditë do të shërbejnë si dokument i frekuentimit të shkollës, deri në një njoftim të dytë.

EDUKOJMË KAMPIONËT E SË NESËRMES

NE JEMI PUNËDHËNËS QË MERR MASA AFIRMATIVE/OFRON MUNDËSI TË BARABARTA

Ne nuk diskriminojmë në bazë të moshës, racës, bindjes, origjinës kombëtare, gjinisë, orientimit seksual ose aftësisë së kufizuar

KLASAT 6-12

Të hënën, më datë 16 mars, të gjithë nxënësit duhet të fillojnë të kenë qasje në detyrat për nxënie në largësi, duke përzgjedhur nivelin përkatës të klasës në tabelën “Remote learning” (nxënia në largësi). Nxënësit duhet të kryejnë detyrat e përcaktuara si “Dita 1” (day 1) të hënën, më datë 16 mars, dhe më pas duhet të vazhdojnë me detyrat e përcaktuara për secilën ditë.

Laptopët e nxënësve do të përdoren për të kryer detyrat e nxënies në largësi. Ju lutem të vini re se nxënësit duhet t’i kryejnë mësimet e caktuara çdo ditë për TË GJITHA lëndët dhe duhet t’ua dorëzojnë detyrat mësuesve në mënyrë elektronike. Mësuesit, këshilluesit, punonjësit socialë, biheviortët, do të jenë të disponueshëm për t’iu përgjigjur çdo pyetjeje, për të ofruar mbështetje akademike dhe këshillim socio-emocional.

Detyrat e kryera për secilën ditë do të shërbejnë si dokument i frekuentimit të shkollës, deri në një njoftim të dytë.

SHPËRNDARJA E KOMPJUTERËVE TEK NXËNËSIT NË KLASAT 5-12

Rrethi shkollor do të vazhdojë t’u vërë në dispozicion laptopë nxënësve të klasave 5-12. Ju lutem, shihni kalendarin e mëposhtëm me qëllim që të merrni një laptop te shkolla e fëmijës suaj, pas plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm. Nëse fëmijës suaj nuk i është dhënë laptop nga rrethi shkollor, ju lutem të bëni të gjitha përpjekjet që të merrni një, duke pasur parasysh këtu rëndësinë që ka kjo pajisje për procesin e nxënien në largësi.

SHPËRNDARJA E LAPTOPËVE PËR NXËNËSIT E KLASAVE 5-12 DO TË KRYHET NË DATAT 16-17-18 MARS:

9:00 a.m. -10:00 a.m.: Shkolla #4 Shkolla #5 Shkolla #6 Shkolla #7

11:00 a.m. -12:00 p.m. Shkolla #8 Shkolla #9 Shkolla #10 Shkolla e ciklit të mesëm të Garfield-it

9:00 a.m.-11:00 a.m.: Shkolla e mesme e Garfield-it

QASJA NË INTERNET

Jemi njoftuar se ofruesit e shërbimit të internetit, siç është ALTICE, po ofrojnë shërbime falas të internetit për familjet të cilat aktualisht nuk kanë qasje në internet. Ne do ta shqyrtojmë këtë çështje në bashkëpunim me zyrtarët e qytetit tonë dhe do t’ju informojmë kur të kemi më shumë të dhëna. Disa telefona inteligjentë mund të përdoren për qasje afatshkurtër në internet, duke përdorur opsionin e hotspotit personal. Ne ju nxisim që të gjeni burime lidhur me sigurimin e qasjes në internet gjatë kësaj periudhe të nxënies në largësi, ndërkohë që ne do të bëjmë gjithçka mundemi për t’ju ndihmuar.

ASISTENCA TEKNIKE

Rrethi shkollor i Garfield-it është i përgatitur të ofrojë asistencë teknike dhe t’i përgjigjet çdo shqetësimi teknik lidhur me laptopët e rrethit shkollor. Do të merren masa akomoduese për të shmangur çdo ndërprerje të procesit të nxënies në largësi. Ju lutemi të kontaktoni me drejtorin e teknologjisë në adresën: drigoglioso@gboe.org dhe/ose telefononi në numrin: 973-340-5010, shtojca: 2231.

EDUKOJMË KAMPIONËT E SË NESËRMES

NE JEMI PUNËDHËNËS QË MERR MASA AFIRMATIVE/OFRON MUNDËSI TË BARABARTA

Ne nuk diskriminojmë në bazë të moshës, racës, bindjes, origjinës kombëtare, gjinisë, orientimit seksual ose aftësisë së kufizuar

VAKTET USHQIMORE QË IU JEPEN NXËNËSVE TË KLASAVE PREK-12, TË CILËT KANË TË DREJTË TË MARRIN DREKË FALAS DHE ME ÇMIM TË ULUR GJATË PERIUdhËS KUR SHKOLLAT QËNDROJNË MBYLLUR PËR NXËNËSIT

Vaktet ushqimore do t'u jepen nxënësve të klasave PreK-12, të cilët kanë të drejtë përfitimi, nga ora 11:30 deri në orën 13:00, duke filluar nga e hëna, më datë 16 mars dhe, gjatë periudhës kur shkolla qëndron e mbyllur, do të vazhdojnë të ofrohen në një vendndodhje qendrore: **3 Saints Church Parking Lot, 454 Outwater Lane.**

Vaktin e drekës do ta merrni me vete; nxënësve nuk do t'iu lejohet të grumbullohen në këtë vendndodhje. Nxënësit e klasave 6-12 duhet të paraqesin letërnjoftimin e nxënësit (student ID).

INFORMACIONE TË TJERA TË RËNDËSISHME:

- Është planifikuar që administratorët të jenë në shkollë çdo ditë nga ora 8:00 e mëngjesit deri në orën 12:00 të drekës, deri në një njoftim të dytë. Do të realizohen vetëm kërkesat urgjente për takime ballë për ballë, për shkak të rrezikut të kontaktit midis personave dhe përhapjes së virusit COVID-19. Ju lutem, përdoreni telefonin dhe emailin si mënyrat kryesore të komunikimit gjatë kësaj krize mjekësore.
- Të gjitha programet bashkëshkollore, ku përfshihen veprimtaritë atletike dhe ekskursionet, janë anuluar ose janë shtyrë.
- Zyra e Bordit të Arsimit do të qëndrojë hapur nga ora 8:00 e mëngjesit deri në orën 12:00 të drekës. Megjithatë, do të kufizohen të gjitha takimet me përjashtim të atyre për çështjet urgjente, deri sa ta kalojmë këtë krizë.
- Regjistrimi i nxënësve të rinj për vitin shkollor 2020-2021 është pezulluar deri në një njoftim të dytë.

PËR MUA, SI MBIKËQYRËSJA JUAJ, ËSHTË E RËNDËSISHME RUAJTJA E SHËNDETIT TË NXËNËSVE TANË, STAFIT, FAMILJEVE DHE ANËTARËVE TË KËTIJ KOMUNITETI.

Ju lutem, mos harroni të vizitoni rregullisht faqen e internetit të rrethit shkollor për informacionet më të fundit lidhur me nxënien në largësi dhe me rihapjen e shkollave. Është shumë e rëndësishme të zbatojmë praktikatat e higjienës së mirë, të shmangim grumbullimet, të mbajmë distancë nga njerëzit dhe të kërkojmë ndihmë mjekësore nëse nuk ndihemi mirë. Le të bëjmë çdo përpjekje për ta tejkaluar këtë situatë së bashku ndërkohë që presim që e ardhmja të jetë më e mirë. Dëshiroj t'ju falënderoj për përkrahjen dhe bashkëpunimin gjatë kësaj pandemie unike dhe të paprecedentë.

Me respekt,

Anna Sciacca

Anna Sciacca, mbikëqyrëse e shkollave publike të Garfield-it

EDUKOJMË KAMPIONËT E SË NESËRMES

NE JEMI PUNËDHËNËS QË MERR MASA AFIRMATIVE/OFRON MUNDËSI TË BARABARTA

Ne nuk diskriminojmë në bazë të moshës, racës, bindjes, origjinës kombëtare, gjinisë, orientimit seksual ose aftësisë së kufizuar

EDUKOJMË KAMPIONËT E SË NESËRMES

NE JEMI PUNËDHËNËS QË MERR MASA AFIRMATIVE/OFRON MUNDËSI TË BARABARTA

Ne nuk diskriminojmë në bazë të moshës, racës, bindjes, origjinës kombëtare, gjinisë, orientimit seksual ose aftësisë së kufizuar